



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



Radio Televizionit "Dukagjini" SH.P.K
Pronar – z. Ekrem LLUKA
TV Dukagjini
Rr/Ismail Qemajli nr. 2
Pejë

Ref: 1509/1122/LIC/II

Vendim

për miratimin e kërkesës për ndryshimin e skemës programore të TV Dukagjini,
Komuna e Pejës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV Dukagjini është Shërbyes Medial Adio-vizual i cili është i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për të transmetuar programe radiotelevizive në Regjionin e Pejës, me seli në Pejë. TV Dukagjini është pajisur me licencë afatëgjatë të transmetimit të KPM-së me datën 28 gusht 2009.
3. Më datën 30 maj 2015, TV Dukagjini ka bërë një kërkesë për ndryshimin e skemës programore, respektivisht, eliminimin e skemës programore që ka të bëjë me Seriale dhe Programin per Fëmijë.

Arsyetimi

4. Kërkesa e parashtruar nga përfaqësuesit e TV Dukagjini nuk ka qenë e qartë, me që ka munguar të dhënat që i zëvendësojnë segmentet e eliminuara, sipas propozimit të TV Dukagjini.
5. Më 1 qershor 2015, KPM i ka dërguar shkresë TV Dukagjinit duke e udhëzuar lidhur me plotësimin dhe sqarimin e detajuar të kërkesës së tyre, me qëllim të vlerësimit nëse ndryshimi i propozuar nga TV Dukagjini për ndryshimin e segmenteve të skemës programore është me interes publik.
6. Më 15 shtator 2015, TV Dukagjini ka dërguar sqarimet e kërkuara nga KPM, duke paraqitur në mënyrë të qartë zëvendësimin e dy segmenteve të eliminuara nga skema programore, me propozimin që ato të zëvendësohen me program informativ.
7. Neni 14, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

“I Licencuari duhet që në transmetimet e veta, si një nga kushtet e Licencës, t’i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe e drejta e përdorimit të spektrit të frekuencës. Dështimi për të vepruar në pajtueshmëri me këtë mund të rezultojë deri në anulimin e Licencës”.

8. Ndërsa Neni 14, paragrafi 2, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së përcakton:

“I Licencuari obligohet që paraprakisht ta njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me propozimin për ndryshime të mëdha të tipit ose burimit të programeve të dhëna në Pjesën 3 të Licencës ose të propozimit të heqjes së një përbërësi të formatit të licencuar. KPM-ja do ta njoftojë të Licencuarin me kohë, në rast se këto ndryshime të propozuara përputhen me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 të licencës së transmetimit në përputhje me kërkesën e të licencuarit.”

9. Ndërsa Neni 2, i Pjesës së tretë të licencës së KPM-së - Formatit i Programit, thekson:

“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t’i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit.”

10. Komisioni konstaton se zëvendësimi i segmentit të skemës programore “Seriale 45.2 % dhe Program për fëmijë 1%” duke e zëvendësuar me transmetimin e programit informativ, është në përputhje me interesin publik.

Vendim

11. Komisioni i KPM-së, me datën 20 tetorë 2015, merr vendim që ta miratojë kërkesën e TV Dukagjini për ndryshimin e skemës programore, respektivisht eliminimin e dy segmenteve programore nga transmetimi dhe zëvendësimin me programet e cekura në kërkesë.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

27.10.2015
datë